

Mejvis Bajollari ka përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare në Shkenca Politike dhe Diplomaci pranë Universitetit të Bristol, në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe studimet pasuniversitare Master Shkencor në Financë-Bankë.

Ajo ka ndërtuar një karrierë profesionale me mbi 20 vite përvojë në administratën publike dhe institucione kombëtare e ndërkombëtare, duke mbajtur pozicione teknike, drejtuese dhe politikëbërëse në sektorë kyçë si shëndetësia, ekonomia, zhvillimi urban, turizmi dhe bujqësia.

Nga viti 2008 deri në vitin 2013, Mejvis Bajollari ka shërbyer si Eksperte Institucionale pranë Agjencisë për Zhvillimin e Zonave Malore, ku ka kontribuar në hartimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore dhe projekteve ndërsektoriale. Në periudhën 2013–2017, ajo ka ushtruar detyrën e Këshilltares Politike të Ministrit të Zhvillimit Urban, duke kontribuar në hartimin e analizave dhe dokumenteve programatike në fushat e zhvillimit urban, legalizimit dhe strehimit.

Nga viti 2017 deri në tetor 2025, ajo ka qenë e angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në sektorin e shëndetësisë, fillimisht si Këshilltare e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, më pas si Drejtore e Drejtorisë së Politikave Farmaceutike, Licencave dhe Lejeve, dhe në vijim si Drejtore e Përgjithshme e Politikave të Shëndetësisë, funksion të cilin e ka mbajtur nga mars 2022 deri në tetor 2025.

Gjatë kësaj periudhe, ajo ka kontribuar në hartimin dhe zhvillimin e politikave dhe programeve kombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve në popullatë, si dhe në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, në përputhje me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian në fushat e farmaceutikës, pajisjeve mjekësore, shërbimit spitalor dhe kujdesit parësor.

Në këtë kuadër, Mejvis Bajollari ka qenë bashkëhartuese e një sërë programesh dhe dokumentesh strategjike kombëtare, përfshirë Programin Kombëtar të Depistimit të Skoliozës për fëmijët e grupmoshës 6–14 vjeç, Programin Kombëtar të Depistimit të Kujdesit Dentar për fëmijët e grupmoshës 6–14 vjeç, Programin Kombëtar të Dëgjimit Neonatal, Programin Kombëtar të Trajtimin Mbajtës me Metadon, Programin Kombëtar për HIV/AIDS dhe Tuberkulozin, si dhe Planin Kombëtar Spitalor. Ajo ka kontribuar gjithashtu në hartimin e ligjit për shërbimin spitalor dhe akteve nënligjore përkatëse.

Paralelisht, ajo ka qenë anëtare e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Infermierit, anëtare e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, si dhe anëtare e Komitetit Drejtues të Shëndetit Riprodhues, duke kontribuar në proceset këshillimore dhe vendimmarrëse në nivel kombëtar.

Që prej nëntorit 2025, Mejvis Bajollari mban pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave të Nxitjes së Biznesit dhe Çështjeve të Tregtisë pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, ku është e angazhuar në hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë zhvillimin ekonomik, nxitjen e biznesit dhe forcimin e integritetit tregtar, duke sjellë në këtë funksion përvojën e saj të gjerë institucionale, ligjore dhe politikëbërëse.